KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMI

01 NR 320-31630/20

Data 02.11.2020

# *KONTRATA NR.088-2020*

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; perfaqesuar nga Menaxheri z. Abaz Foniqi,

dhe

BLETARIJA TE AHMETI SHPK " adresa CECELI –Komuna Vushtrrise , me numer Bisnesi ABRK 810200080 , me perfaqesues z. VISAR KRASNIQI (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për sherbimet ne vijim .

**Titulli: FURNIZIM ME KOSHERE BLETESH PER BLETAR INDIVIDUAL**

Ne baze te procedures se prokurimit nr. 634-20-5532-121/634-20-090-121

**Neni 1 Lënda. Furnzim sipas ofertes finaciare**

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Furnzimeve ne vijim.

| Nr. | Titulli | Çmimi për njësi (me TVSh) | Sasia | Njësia matëse | Totali (me TVSh) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | KOSHERE BLETESH SIPAS SPECIFIKIMIT MINMAL TE OBLIGUESHEMSPECIFIKACIONI QE DUHET TE I PERMBUSH KOSHERJA - Koshereve duhet t'iu vendoset logoja identifikuese Komuna Klinë –Drejtoria e Bujqësisë, më gjatësi 5.0 cm dhe gjerësi 5.0 cm,e metalt ose bakër. - Kosheret duhet të jenë nga druri qamë ose bre i bardh. - Lidhja e koshereve duhet të jetë më olluk. -5 Montimi i koshereve duhet të bëhet me shrafa më gjatësi 5.5 mm. - Dimensioni i koshereve duhet te jetë standard. - Dimensionet – gjatësia 50.50 cm, gjerësia 41.20 cm, lartësia 24.20 cm, më trashësi 2.00 cm. - Rahmet duhet të jenë të punuara nga druri i llojit blinj, me korniza të shpuara. - Podi i kosheres duhet të jetë i thjesht dhe nga druri. - Ushqyesja duhet të jetë me ventilim, dhe atë 70 % e mbuluar më dru dhe 30% më ventilim. - Trashësia e ushqyeses duhet të jetë 1 cm - Lartësia e ushqyeses duhet të jetë 7.5 cm. - Kapakët e kosheres duhet të jenë të punuara nga druri dhe llamarina. - Kosheret duhet të jenë të ngjyrosura. | 35.40 | 400.00 | COPE | 14,160.00 |

3.2.Vlera totale indikative e kontratës është 14.160.00 €

**( Katermbdhjetmijenjeqindegjashtedhjeteeuro )**

3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.4 Çmimet e njësive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

**3.5. Plani i kryerjes furnzimeve do te behet sipas kerkesave te A.K sipas listes se perfitueseve te perzgjedhur nga Drejtoria e Bujqesise dhe Zhvillimit rural .**

**Shperndarja do te behet tek perfituesit ne prani te caktuar nga drejtoria , Perfituesit individual dhe O.E . Me raport mbi pranim –dorzimin e Koshereve .**

**3.6. Kosheret duhet te i permbahen specifikacionit teknik te kerkuar nga A.K ne pershkrimin teknik ne Cmimore Dhe deklarates se ofertuesit .**

**Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

(b) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;

(c) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

(d) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 5 Pagesat**

5.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

5.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

**5.3. Pagesat do te ekzekutohen me keste sipas dinamike se kryerjeve te punimeve Pagesat do te behen sipas situacineve mbi kryerje te punimeve me Raport nga Komisioni dhe Fatura.Jo me teper se 30 dite pas pranimit te fatures dhe Raportit .**

**Neni 6 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

6.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

6.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 7 Kualiteti**

7.1 Kualiteti i *puneve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

7.2. Kryesi i puneve do te jete pergjegjes per Demtimet te shkaktuara me dashje apo pa kujdesi ne masen e demit qe do te percaktohet nga zyrtari pergjegjes .

**7. 3. Garancioni i Kontrates do te depozitohet ne vlere 1.416.00 €**
me validitet 6+1 = 7 muaj

**Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Ne raste deshtimit apo voneses ne Implementim , Do te penalizohet me masen 0.25% ne dite vonese nga vlera totale e kontrates.

**Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here tëinspektojë, kontrollojë, dhe te shikoj furnizimet e bera nese eshte ne masen e cilesive te kerkuara .

**Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

10.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

11.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 5 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

12.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

12.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykaten themelore _dega Kline në pajtim me ligjin e Kosovës.

**Neni 13 Komunikimi**

13.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë

13.2 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose"vendosë "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

Neni 14. Menaxhimi i projektit dhe menaxhimi i kontrates .

14.1. Menxhimi i projektit do te behet nga njesia kërkuese –Implementuese Drejtoria KOMUNA E BUJQESISE DHE ZHVILLIMIR RURAL Komuna Kline

14. 2 .Menxhimi i Kontrates . Bazuar ne neni 81 te LPP , Menaxhi i kontrtaes me vendim te ZKA do te jete : ______________________ nga ______________________

14.3 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

| | |
|---|---|
| **Emri:** | ABAZ FONIQI |
| **Pozita:** | Zyrtar përgjegjës i prokurimit |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 02. 11. 2020 |
| **Vula:** | |

**Për Ofruesin e Shërbimeve BLETARIJA TE AHMETI SHPK –CECELI - VUSHTRRI**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | VISAR KRASNIQI |
| **Pozita:** | |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | |
| **Vula:** | |

***PJESA IV E KONTRATËS: MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT***

**Për: KOMUNA KLINE**
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues"

**Në emër të: BLETARIJA TE AHMETI SHPK – CECELI - VUSHTRRI**
(në vazhdim "operatori ekonomik")

**Titulli i aktivitetit të prokurimit: FURNZIM ME KOSHERE BLETESH PER PERFITUESIT INDIVIDUAL**

**Numri i Prokurimit:** 634-20-5532-121/634-20-090-121

**Garancion me kërkesë te pare**

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t`i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **1.416.00 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **1.416.00 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

**Kjo siguri vlen deri me: 6+1 MUAJ**

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

______________________________

Emri i institucionit financiar

______________________________

Adresa

______________________________

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Minstarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK
AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

# CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
# CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
# CERTIFICATE OF REGISTRATION

**810200080**

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

**Bletaria Te Ahmeti SH.P.K.**

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

**///**

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

| | |
|---|---|
| Lloji biznesit:<br>Poslovni tip:<br>Business type: | Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara<br>Društvo sa ograničenom odgovornošću<br>Limited Liabilities Companies |
| Adresa:<br>Adresa:<br>Address: | Nexhid Hasani<br>Ceceli<br>Vushtrri |
| Data e regjistrimit:<br>Datum registracije:<br>Date of registration: | 20/10/2016 |

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
QKB-OCB
Vushtrri
Vučitrn

20/11/2019
Data / Date / Datum

Nënshkrimi / Signature / Potpis

BLETARIA TE AHMETI SH.P.K.
VUSHTRRI

# DEKLARATË

Ne me anë të kësaj deklarate Bletaria te Ahmeti SHPK me Nr.UNI:810200080 në Vushtrri, DEKLARON se Kosheret e furnizuara do të jenë konform specifikave dhe do të furnizohen sipas afatit të kërkuar.

Vushtrri
13.10.2020

BLETARIA TE AHMETI SHPK

# Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **88371**

Për **Komuna Kline**
( Emri i "Autoritetit Kontraktues" )

Në emër të **Bletaria Te Ahmeti shpk**
(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operaratori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Furnizim me koshere bletesh per bletar individual.**
Nr. prokurimit: 634-20-5532-1-2-1 , Nr. brendshëm: 634-20-090-121

## Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.
Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **1,416.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilen deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

a. Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratëne e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
b. Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **1,416.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 214 ditë kalendarike prej **02.11.2020** deri më **04.06.2021**

Data lëshimit: 02.11.2020
Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

BLETARIA TE AHMETI

KOMPANIA E SIGURIMEVE ELSIG PRISHTINË - KOSOVË INSURANCE COMPANY

Nr i Serisë 0051917